



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Pml.nr.759/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Afrim Shala, kryetar i kolegjit, Rasim Rasimi dhe Agim Maliqi, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, si procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarve I. M. dhe M. M. nga fshati K. e V., Komuna e P., për shkak të veprave penale: fajdeja nga neni 331 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 2 të KPRK-së dhe veprës penale detyrimi nga neni 328 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 2 e nenin 28 të KPRK-së secili veç e veç, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të të dënuarve, të paraqitura kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.1117/2021, të datës 11.03.2024 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, PA1.nr.1123/2024, të datës 17.09.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 19.12.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si e pabazuara kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësve të të dënuarve I. M. dhe M. M., të paraqitura kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.1117/2021, të datës 11.03.2024 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, PA1.nr.1123/2024, të datës 17.09.2024.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.1117/21, të datës 11.03.2024, të dënuarit I. M. dhe M. M., janë shpallur fajtor për shkak të veprave penale fajdeja nga neni 331 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 2 të KPRK-së dhe veprës penale detyrimi nga neni 328 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 2 e nenin 28 të KPRK-së, secili veç e veç, dhe pasi

që i ka përcaktuar të dënuarve dënimet për secilën vepër penale veç e veç, në pajtim me nenin 76 të KPRK-së iu ka shqiptuar dënimin unik me burgim të dënuarit I. M., dënimin unik me burgim në kohëzgjatje prej 22 (njëzet e dy) muajve dhe dënimin me gjobë në shumë prej 5.000 (pesëmijë) €, ndërsa të dënuarit M. M. dënimin unik me burgim në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 7.000 (shtatë mijë) €. Të dënuarve në dënimin unik të shqiptuar iu ka llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga datat 16.12.2019 e deri më datë 05.05.2020.

Dënimin me gjobë të dënuarit janë të obliguar ta paguajnë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, dhe nëse të dënuarit nuk mund ose nuk dëshirojnë ta paguajnë gjobën, dënimi iu zëvendësohet me dënim me burgim duke llogaritur 20 € me një ditë burgim. Janë obliguar të dënuarit që ti paguajnë shpenzimet e procedurës penale sa ato të bëhen, në emër të paushallit gjyqësor secili shumë prej nga 50 € , për kompensimin e viktimave të krimit secili shumë prej nga 20 €.

Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin e PA1.nr.1123/2024, e datës 17.09.2024, i ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të dënuarve, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kanë paraqitur:

- mbrojtësi i të dënuarit I. M. avokati Xheladin Osmani, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës penale, për shkak të shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale ku shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor dhe shkeljes së ligjit penal, dhe vendimit mbi dënimin me propozimin që Gjykata Supreme e Kosovës kërkesën ta aprovon si të bazuar, ndërsa aktgjykimet e kundërshtuara t'i anulon dhe çështjen t'ia kthen gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

- mbrojtësi i të dënuarit M. M. avokati Bajram Hamitaga, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës penale, për shkak të shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale ku shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor dhe shkeljes së ligjit penal, me propozimin që Gjykata Supreme e Kosovës kërkesën ta aprovon si të bazuar, ndërsa aktgjykimet e kundërshtuara t'i anulon dhe çështjen t'ia kthen gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.434/2024, e datës 11.12.2024, ka propozuar që kërkesat për mbrojtje e ligjshmërisë të mbrojtësve të dënuarve të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), si dhe pasi i vlerësoi pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe përgjigjen në kërkesë të Kryeprokurorit të Shtetit, gjeti se:

- kërkesat janë të pabazuara.

Mbrojtësit e të dënuarve I. M. dhe M. M. në kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë pretendimet i kanë të ngjashme me pretendimin se, aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, për shkak se dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është i pakuptueshëm, kundërthënës në brendinë e tij, në të nuk janë paraqitur arsyet lidhur me faktet vendimtare dhe sidomos kur bëhet fjalë për veprën penale detyrimi në tentativë nga neni 328 paragrafi 1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së. Pretendohet më tutje në kërkesë se sipas bindjes së mbrojtjes kjo veprë penale nuk mund të qëndroj si e tillë, sepse mund të ekzistojë detyrimi ose mos të ekzistoj fare, për faktin se deri më tani praktika gjyqësore nuk ka përmendur të ketë ndonjë rast të detyrimit në tentativë. Më tutje theksohet se prokuroria në aktakuzën e saj në arsyetimin e saj është përqendruar vetëm në veprën penale të fajdesë kurse me asnjë provë në rastin konkret nuk ka dëshmuar se ku dhe kur ka ndodhur tentativa dhe si është shprehur nga ana e të dënuarve ndaj të dëmtuarit B. Q.. Po ashtu në kërkesë pretendohet se edhe aktgjykimi i shkallës dytë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe si i tillë është i paqartë por edhe kontradiktore me vet veten. Pretendohet po ashtu edhe për vendimin mbi dënimin, kur kihet parasysh se gjykata e shkallës së parë të gjitha rrethanat i ka vlerësuar në dëm të dënuarve.

Gjykata Supreme e Kosovës pas shikimit të shkresave të lëndës konstatoi se kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të të dënuarve janë të pabazuara, për faktin se aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë nuk janë të përfshira me ndonjë shkelje të esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe as me shkelje të ligjit penal në dëm të të dënuarve I. dhe M. M..

Mbrojtësit i të dënuarve në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë nuk kanë specifikuar konkretisht se ku qëndrojnë shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1 të KPP-së, përveç se i përmendin si të tilla. Sidoqoftë, Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka vërejtur që aktgjykimet e kundërshtuara të jenë përfshirë me shkelje të këtyre dispozitave të procedurës penale, pasi që dispozitivi i aktgjykimeve në fjalë është i qartë, nuk është kundërthënës, ndërsa në arsyetimet e tyre janë paraqitur arsye të mjaftueshme për të gjitha pikat,

përkatësisht çështjet e rëndësishme, andaj edhe si të tilla, këto aktgjykime rezultojnë se janë përpiluar konform dispozitës përkatëse ligjore nga neni 369 të KPP-së.

Po ashtu lidhur me pretendimin e mbrojtësve të dënuarve se me asnjë provë nuk është dëshmuar se të dënuarit ta kenë detyruar të dëmtuarin për marrjen e veprimeve në dëm të tij dhe se me këtë rast vepra e detyrimit në tentativë nuk mund të ekzistoj, sipas vlerësimit të kësaj gjykate ky pretendim i mbrojtjes është i pabazuar. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyetim të plotë dhe të mjaftueshëm përkitazi me veprimet inkriminuese të të dënuarve përkitazi me veprën penale të detyrimi të mbretur në tentativë.

Në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë janë përshkruar qartë dhe në mënyrë të plotë veprimet inkriminuese të të dënuarve ndaj të dëmtuarit, për veprat penale për të cilat janë shpallur fajtor. Me provat e administruara gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se të dënuarit I. dhe M. M. në periudhën kohore prej 05.12.2019- deri 16.12.2019 me dashje kanë ndërmarrë veprime për kryerjen e veprës penale detyrim, në atë mënyrë që me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete kanë përdorë kanosjen serioze në mënyrë permanente ndaj të dëmtuarit B. Q., për ta detyruar këtë të fundit që të kryej punën në dëm të pasurisë së tij. Nga provat e administruara- leximi i transkriptove të bisedave dhe përgjimeve për datat 05.12.2019,06.12.2019,07.12.2019,09.12.2019,10.12.2019, 15.12.2019 dhe 16.12.2019 të siguruara sipas urdhërësës së gjykatës, gjykata ka vërtetuar se në mes të dëmtuarit B. Q. dhe të dënuarve I. dhe M. M., ka pasur biseda të cilat janë transkriptur dhe gjenden në shkresat lëndës e të cilat vërtetojnë objektin akuzës se të dënuarit kanë përdor fjalë detyruese ndaj të dëmtuarit B. Q., kanë kërkuar përqindje të ndryshme interesi në disproporcion me shumat e dhëna, duke e kanosur me fjalë të ndryshme, të cilat fjalë të kanosjes dhe detyrimit të përdoruar ndaj të dëmtuarit B. Q. janë të përshkruara detajisht si në provat e administruara- transkriptet e bisedave dhe përgjimeve.

Gjykata me provat e administruara drejtë ka konstatuar se të dënuarit me dashje kanë ndërmarr veprime me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, kanë përdor kanosjen serioze në mënyrë permanente ndaj të dëmtuarit B. Q., për ta detyruar këtë të fundit të kryej veprim në dëm të pasurisë së tij dhe atë duke e kanosur me qëllim të realizimit të përfitimit nga kontraktimi i shumës, dukshëm jo proporcionale të përshkruara më afër si në dispozitiv të aktgjykimit. Pra kur të dënuarit kanë tentuar me kërcenim permanent ta detyrojnë të dëmtuarin që të kryej veprim në dëm të pasurisë së tij, ka konsumuar të gjitha elementet e veprës penale të detyrimit në tentativë të parashikuar nga neni 328 paragrafi 1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, prandaj pretendimet e mbrojtjes në këtë drejtim dalin të jenë të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës e konsideron të pabazuar edhe pretendimin e mbrojtësve të dënuarve në lidhje me shkeljen e ligjit penal, për faktin se në veprimet e të dënuarve janë

përbushur të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprave penale për të cilat të dënuarit janë shpallur fajtor, për faktin se në veprimet e tyre janë përbushur të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale fajdeja nga neni 331 paragrafi i lidhur me paragrafin 2 të KPRK-së dhe veprës penale detyrimi nga neni 328 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 2 e nenin 28 të KPRK-së.

Në fund, duhet theksuar se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është paraqitur edhe sa i përket vendimit lidhur me dënimin, mirëpo bazuar në nenin 432 të KPP-së nuk është e lejuar që të paraqitet ky mjet juridik për shkak të vendimit lidhur me dënimin.

Përndryshe, edhe në këtë çështje penale, Gjykata Supreme e Kosovës rithekson se matja e dënimeve dhe vlerësimi i rrethanave përkatëse relevante është në kompetencë të gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë, varësisht nga rrethanat e rastit, ndërsa duke u bazuar në nenin 432, paragrafi 1 të KPP-së, këto pretendime në lidhje me shqiptimin e dënimeve më të buta, nuk mund të jetë arsye për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë.

Andaj, edhe nga arsyet e cekura më lart, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pabazuar dhe pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.759/2024, më datë 19.12.2024

Procesmbajtës,

Bujar Balaj

Kryetar i kolegjit,

Afrim Shala